

# **PROGRAME TË ARSIMIT PARASHKOLLOR**



**Tiranë, 2006**

**"Testi i vërtetë i tërë procesit  
mësimor-edukativ është  
lumturia e fëmijës"**

**-Maria Montessori-**

## **PROGRAMI I PARASHKOLLORIT**

### **A. FUSHAT KURRIKULARE**

- 1. Zhvillimi gjuhësor**
- 2. Zhvillimi matematikor**
- 3. Zhvillimi Shkencor**
- 4. Zhvillimi social dhe personal**
- 5. Edukimi artistik**
- 6. Edukimi fizik dhe shëndetësor**

### **B. SHTOJCË**

## **PROGRAMI I ZHVILLIMIT GJUHËSOR PËR GRUPIN E FËMIJËVE 5-6 VJEÇ NË ARSIMIN PARASHKOLLOR**

### **1. HYRJE**

Programi i zhvillimit gjuhësor për moshën 5-6 vjeçare të arsimit parashkollor përfshin disa linja të rëndësishme të gjuhës amtare si: komunikimi, të menduarit, lidhja e tingujve me shkronjat, të shkruarit, si dhe shkrimin e dorës.

Të gjithë këto linja synojnë t'i pajisin fëmijët e kësaj moshe me njohuritë, aftësitë e domosdoshme për të përballuar kërkesat e kësaj fushe formimi kur ata të futen në shkollë, si dhe të mundësojë një përfshirje të natyrshme në këtë proces të të gjithë fëmijëve të kësaj moshe, duke marrë parasysh problemet, aftësitë, prirjet e tyre në mënyrë të tillë, që ky program të plotësojë jo vetëm boshllëqet e fëmijëve që nuk kanë vijuar rregullisht kopshtin, por dhe të përmirësojë dhe të stimulojë aftësitë e atyre që kanë vijuar rregullisht.

Në këtë kuptim ky program mund të duket i lehtë për ata fëmijë që kanë qenë gjithmonë prezent në veprimtaritë mësimore në kopsht, por trajtimi, ngarkesa e kësaj fushe, si dhe mënyra se si do të mund të zhvillohet konkretisht në kopsht, është një mundësi e mirë që të gjithë fëmijët si në zonat urbane, në zonat rurale t'u jepet një shans i barabartë për sa i takon kërkesave dhe mundësive për një formim gjuhësor të vlefshëm për perspektivën e afërt të tyre si nxënës në shkollë.

### **2. LINJAT KURRIKULARE TË ZHVILLIMIT GJUHËSOR**

#### **Linjat:**

- Gjuhë për komunikim
- Gjuhë për të menduar
- Lidhja e tingujve me shkronjat
- Të lexuarit
- Të shkruarit
- Shkrim dore

Linjat e formimit gjuhësor të përmendura më lart do të synojnë krijimin e aftësive fillestare për të shkruarit, të lexuarit, por në mënyrë të veçantë me elementë të të menduarit dhe të komunikimit, të cilat do të mundësojnë një reflektim dhe nxitje të të menduarit konkret, por pse jo dhe reflektiv dhe krijues në disa raste, të cilat bazohen nga situata reale të jetës së fëmijëve. E gjithë kjo do të sjellë dhe krijimin e aftësive komunikuese të tyre për t'u shprehur lirshëm, të qetë dhe të sigurt, duke paraqitur me lehtësi idetë, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre, si dhe duke nxitur gjithmonë tek ata një komunikim normal, të qetë dhe brenda etikës dhe normave morale të pranuara në kontekstin shoqëror ku ata bëjnë pjesë dhe jetojnë, si kopsht, shoqëri, familje dhe komunitet.

**3. PROGRAMI I DETAJUAR I FORMIMIT GJUHËSOR SIPAS LINJAVE,  
OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE**

Nr	Linjat	Objektivat	Konceptet
1	<b>Komunikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor shpesh fjali dhe pyetje të thjeshta me anë të gjesteve</li> <li>• Përdor intonacion, ritëm të qartë gjatë komunikimit, i cili është i kuptueshëm për të tjerët</li> <li>• Pyet pse shumë gjëra ndodhin dhe jep dhe shpjegime</li> <li>• Dëgjon histori dhe merr pjesë në biseda me një vëmendje gjithnjë e në rritje</li> <li>• Merr pjesë dhe ka iniciativë për të diskutuar në mjedisin e të nxënësit jo vetëm me moshtarët, por dhe më të rriturit.</li> <li>• Vëzhgon rregullat e diskutimit dhe i zbaton ato edhe si folës, por dhe si dëgjues</li> <li>• Formulon mendime të qarta duke përdorur fjali të sakta që shprehin ide</li> <li>• Përdor intonacion të ndryshëm, duke strukturuar fjalitë dhe idetë e tij kur flet.</li> <li>• Flet rreth karaktereve, vendit dhe ngjarjeve të përmbajtjes së pjese të dëgjuara ose të lexuara</li> <li>• Tregon respekt për të tjerë kur flasin dhe kur ai merr fjalën e tij.</li> </ul>	<p>-Pyetje</p> <p>-Intonacion</p> <p>-Diskutim</p> <p>-Histori</p> <p>-Folës</p> <p>-Dëgjues</p> <p>-Rregulla të foluri</p> <p>-Gjeste</p> <p>-Mendime të qarta dhe me ide</p> <p>-Respekt</p>
2	<b>Të menduarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor të folurit në bisedë duke i dhënë një kuptim të ri një objekti ose një veprimi të caktuar</li> <li>• Përdor të folurit në bisedë duke i lidhur idetë e tij, por dhe duke parashikuar se çfarë mund të ndodhë më tej</li> <li>• Përdor të folurit në bisedë për të risjellë në kujtesë, si dhe për të rijetuar përvojat jetësore që ka kaluar</li> </ul>	<p>-Të folurit</p> <p>-Të menduarit</p> <p>-Parashikimi</p> <p>-Lidhja e ideve</p> <p>-Kujtesa,</p> <p>-Përvojë personale</p>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Përbledh përvojat personale duke i lidhur me materialet që i lexohen ose që i lexon</li> </ul>	<b>jetësore</b>
3	<b>Lidhja e tingujve me shkronjat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon me saktësi se secilës shkronjë i korrespondon një tingull</li> <li>Shfaq një të kuptuar të qartë të përdorimit të rimës dhe aliteracionit</li> <li>Përdor qartë rimën, si dhe shumë tinguj në fjalët e folura</li> <li>Thotë secilin tingull duke e lidhur saktë me shkronjën</li> <li>Identifikon saktë në një fjalë ose në një pikturë të njëjtën shkronjë ose tingull gjuhësor</li> </ul>	<b>-Rimë</b> <b>-Ritëm</b> <b>-Tingull</b> <b>-Shkronjë</b> <b>-Fjalë</b>
4	<b>Të lexuarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Demonstron një të kuptuar të qartë se si një material është paraqitur i shkruar dhe si mund të lexohet</li> <li>Mban një material të shkruar në pozicionin e saktë për të lexuarit</li> <li>Identifikon saktë faqen e parë të një libri si dhe titullin e tij</li> <li>Thotë secilën shkronjë duke ndjekur me gisht materialin e shkruar nga e djathta në të majtë të faqes</li> <li>Identifikon qartë hapësirat midis fjalëve si dhe përbërjen e fjalëve si një kombinim i shkronjave</li> <li>Çifton me zë në një tekstu duke shoqëruar shkronjat, rrokjet, fjalët dhe fjalitë në një material të shkruar</li> <li>Shpjegon se çfarë informacioni mund të marrë nga një material i shkruar</li> <li>Identifikon firmat, logot, simbolet e njëjta në një material</li> <li>Lexon dhe shpjegon të shkruarit dhe të vizatuarit e tij</li> </ul>	<b>-Material i shkruar</b> <b>-Pozicion i saktë i të lexuarit</b> <b>-Tingull</b> <b>-Shkronjë</b> <b>-Hapësirë midis fjalëve</b> <b>-Çiftim</b> <b>-Informacion</b> <b>-Simbole të njëjta</b> <b>-Të vizatuarit dhe të shkruarit</b>
5	<b>Të shkruarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkruan saktë emrin e tij dhe të pjesëtarëve të familjes me shkronja kapitale</li> <li>Përdor mirë ngjyrat, lapsin, stilolapsin në të shkruar</li> <li>Identifikon lehtë materialet që përdoren për të shkruar</li> <li>Demonstron me anë të pikturës që</li> </ul>	<b>-Emri</b> <b>-Mjetet e të shkruarit</b> <b>-Lidhja pikturës midis dhe ngjarjeve</b>

		<p>bën sekuanca të ngjarjeve që ka dëgjuar ose parë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikon shkronjat, pikturat dhe objektet</li> </ul>	<b>-Klasifikimi</b>
<b>6</b>	<b>Shkrim dore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon qartë shkronjat kapitale nga ato të dorës</li> <li>• Respekton gjatë të shkruarit vijat, hapësirat dhe linjën q duhet të ndjekë duke demonstruar një vetëkontroll motorik</li> <li>• Shfaq dëshirë të vazhdueshme për të shkruar shkronjat e mëdha dhe të vogla të dorës, si dhe kapitale</li> </ul>	<p><b>-Shkronja dore të mëdha dhe të vogla</b></p> <p><b>-Shkronja kapitale të mëdha dhe të vogla</b></p>

#### **4. Mjete të domosdoshme:**

- Laps i zi, stilolaps,
- Ngjyra (gjashtë ngjyra si: e kuqe, blu, e verdhë, jeshile, kafe, e zezë),
- Fletore shkrimi për këtë grupmoshë,
- Fletë të bardha A.4, fletë të mëdha të bardha ( flipcharts),
- Ngjitës, gërshërë 10 cm për këtë grupmosh,
- Shkumësa me ngjyra,
- Libra për fëmijë me tregime të përshtatshme për botën e tyre, libra me përralla të njobura, CD me përrallat më të njobura nga fëmijët si "Hirushja", "Borëbardha" etj.,
- Kompleti i madh i shkronjave kapitale dhe të dorës i mësuesit, shkronja të dorës plastikë të magnetizuara,
- Tabelë magnetike e klasës, album me shkronja dhe figura,
- Penj me disa ngjyra ku mund të përdoren dhe futen lirshëm shkronjat për të formuar fjali,
- tabela të vogla shkrimi druri për secilin fëmijë

#### **5. UDHËZIME DIDAKTIKE**

Ky program nuk do të zhvillohet i shkëputur nga fushat e tjera të formimit për këtë grupmoshë, përkundrazi formimi gjuhësor do të jetë të qendër dhe do të mund të integrojë natyrshëm brenda tij të gjitha drejtimet e tjera si edukim matematikor, fizik, edukim në arte, edukim mjedisor etj, që do tëjenë pjesë e një programi holistik për këtë grupmoshë.

"Të punuarit me projekte" është një mundësi shumë e mirë për të ndërthurur së bashku fushat e ndryshme të formimit, ku padashim ai gjuhësor ka një rol të rëndësishëm, pasi nga njëra anë lehtëson formimin në fusha të tjera, përmes

përdorimit të tē folurit dhe tē shkrimit, por fushat e tjera shërbejnë dhe plotësojnë arritjen dhe përbushjen e kérkesave që formimi gjuhësor ofron.

Në këtë kontekst formimi gjuhësor do të jetë një proces i gjatë integrimi ku objektivat e kësaj fushe do të mund të ndërthuren me objektivat që synojnë fusha të tjera dhe konkretisht duke shfrytëzuar të vizatuarit, të kënduarit, lëvizjen, veprimtaritë e thjeshta matematikore, do të mund të mësojnë dhe të arrijnë kérkesat e linjave që ofron fusha e formimit gjuhësor.

Nga ana tjetër edhe linjat që paraqiten në program nuk mund të zhvillohen të shkëputura dhe të ndara. Objektivat e secilës linjë shërbejnë dhe për kérkesat dhe konceptet që synojnë dhe linjat e tjera brenda fushës. Nuk mund të mendohet një formim gjuhësor ku të shkruarit është i shkëputur nga tē folurit, ose këto tē dyja nga komunikimi. Formimi gjuhësor është një proces kompleks që kërkon një gërshtetim të harmonishëm midis objektivave të linjave dhe një mësuese e kujdeshme i vendos ato në funksion të njëra-tjetrës. Kjo i jep më shumë gjallëri të punuarit me projekte, e cila në fakt kërkon shumë kohë, por ne sugjerojmë që në varësi të objektivave që ofrojnë fushat e ndryshme të formimit të përcaktojmë një periudhë 1-mujore për maksimumin e një projekti, i cili do të punojë mbi një tematikë njëmuore, duke ndërthurur një tërësi objektivash brenda fushës së formimit gjuhësor, por natyrisht dhe nga fusha të tjera të formimit.

Në këtë projekt formimi gjuhësor zë një vend tē posaçëm dhe kërkon më shumë kohë, pasi çdo veprimtari që do të zhvillohet me fëmijët bazohet në komunikimin gjuhësor. Themeli i marrëdhënieve mësues-fëmijë është ndërveprimi ku mjedisi, bashkëpunimi fëmijë-fëmijë, përdorimi i mjeteve dhe materialeve stimulon gjithmonë një pjesëmarrjeje aktive të fëmijëve në tē nxënë. Loja dhe ushtrimet në grupe dhe individuale sugjerohen tē konsiderohen prioritare në formimin gjuhësor, sidomos në linjat e tē folurit, tē shkruarit dhe tē menduarit.

## PROGRAMI I ZHVILLIMIT MATEMATIKOR PËR GRUPIN E FËMIJËVE 5-6 VJEÇ NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

### 1. HYRJE

Hapat e para të fëmijëve në procesin e të nxenit kanë një rëndësi të madhe në formimin e mëtejshëm të tyre. Në moshën 5-6 vjeç kapaciteti për të nxenë është mjaft i madh. Fëmijët e kësaj moshe zotërojnë një sërë shprehish, njojurish e qëndrimesh të cilat ndikojnë në aftësispëri e tyre për të nxenë, në zhvillimin e personalitetit, në marrëdhëni me të tjerët dhe në pjesëmarrjen e tyre të ardhshme në jetën shoqërore.

Në kohën e sotme fëmijët zhvillohen në disa mjedise: në shtëpi, në mjediset përreth shtëpisë dhe sigurisht edhe në kopësht i cili është shkolla e tyre e parë. Mësimi në kopësht siguron bazën për zotërimin e shprehive të të shkruarit e të lexuarit, e shprehive matematikore, e shprehive shkencore dhe i përgatit ata për të qenë të sukseshsëm në vitet e mëtejshme të shkollimit.

Fëmijët vijnë në kopësht nga mjedise të ndryshme familjare dhe zhvillimi i tyre nuk është për të gjithë në të njëjtën stad. Për t'i dhënë çdo fëmije fillimin më të mirë të mundshëm është e rëndësishme që programet e kopshtit të sigurojnë një shumllojshmëri mundësish të të nxenit

### 2. KARAKTERISTIKAT E MËSIMIT TË MATEMATIKËS

Në kopsht, matematika nuk konceptohet si lëndë apo si fushë e veçantë, por si një pjesë integrale e aktiviteteve të përditshme Gjithsesi **mësimi i imatematikës**, në arsimin parashkollor, ka karakteristikat e mëposhtme:

#### a. Të nxenit e integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme

Shumica e fëmijve vijnë në kopësht me një bagazh jo të vogël njojurish intuitive matematike të cilat i kanë përfthuar nëpërmjet kuriozitetit për botën që i rrtheon dhe nëpërmjet aktiviteteve që kanë kryer (psh lojrat e ndryshme me kuba). Të mësuarit e matematikës në kopësht ndërtohet pikërisht mbi këtë bazë dhe e zhvillon më tej atë.

Të nxenit në matematikë bëhet më mirë nëse lidhet dhe integrohet me atë të fushave të tjera. Një rëndësi i kushtohet lidhjes më artin sepse siguron perceptim dhe motivim të lartë nga ana e fëmijve. Nëse situatat matematikore janë të lidhura me jetën e përditshme të fëmijve, atëherë ato bëjnë të mundur që fëmijët të zbatojnë atë që dinë dhe të zhvillojnë njouri të reja. Psh nëse fëmijët matin rritjen dita ditës të gjatësisë së një bimë të mbjellë në vazo ose në kopësht ata forcojnë dijet e tyre si në matematikë ashtu edhe në shkenca.

#### b. Të nxenët nëpërmjet lojrave zbuluese

Zhvillimi fizik, socio-emocional dhe intelektual i fëmijve varet nga aktiviteti që kryen,. Në kopësht një nga aktivitetet më efikase është loja. Nëpërmjet lojës fëmijët imitojnë të rriturit dhe eksperimentojnë atë që kanë parë, mësojnë si t'i zgjidhin problemat dhe të punojnë bashkarisht me të tjerët. Nëpërmjet lojrave fëmijët në mënyrë aktivë zbulojnë mjedisin që i rrtheon dhe u përgjigjen shumë

pyetjeve. Loja dhe puna për fëmijët nuk janë kategori të ndara. Tipet e lojës janë disa; lojë së bashku e paorganizuar ku fëmijët luajnë me njëri tjetrit, sipas dëshirës së tyre; lojë së bashku e organizuar ku fëmijët luajnë me njëri tjetrit sipas një qëllimi, lojë më vete ku fëmija luan vetë i pavarur, lojë ku fëmijë luan vetë por duke parë të tjerët. Kur fëmija fillon të luajë me të tjerët në një lojë të organizuar atëhere do të thotë që ai është në gjindje të ndjekë rregulla. Lojrat e organizuara, së bashku ose më vete janë më të përshtashme për përvetësimin e koncepteve matematike.

### 3. Objektivat sipas linjave të përbajtjes

LINJAT	NËNLINJAT	KONCEPTET	OBJEKTIVAT	MATERIALET
1. NUMRI	<b>1.1 Numri</b> <b>1.2 Veprimet me numrat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimi i numrit natyror deri në 20;</li> <li>- Koncepti i numrit rreshtor;</li> <li>- Vargu numerik;</li> <li>- Leximi dhe shkrimi i numrave deri në 10;</li> <li>- Krahasimi dhe rradhitja e numrave;</li> <li>- Mbledhja e numrave deri në 10;</li> <li>- Zbritja brenda 10;</li> <li>- Zbatime në situate; problemore të njoitura nga fëmijët, me një veprim;</li> <li>- Monedhat</li> </ul>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të numëroje të paktën deri në 20.</li> <li>• Të lexojë numëroret të paktën deri në 20.</li> <li>• Të shkruajë numëroret të paktën deri në 10.</li> <li>• Të krahasojë dy numra deri në 10 bazuar në dy grupe sendesh.</li> <li>• Të renditë në rritje të paktën deri në 20 dhe në zbritje duke filluar nga 10;</li> <li>• Të mbledhë deri në 10 dy numra natyrorë duke bashkuar dy grupe sendesh.</li> <li>• Të zbresë dy numra natyrorë duke e konkretizuar me grupe sendesh (p.sh. 7 mollë heqim 2 mollë, mbeten 5 mollë).</li> <li>• Të zgjidhë problema të thjeshta me një veprim, me mbledhje dhe zbritje, në situate konkrete që dalin</li> </ul>	Materiale të imta; materiale të riciklueshme; petëza; tabela manjetike; grafikë të numrave; kuti me forma të ndryshme; birila; domino; letra bixhozi; numératore me gogla; vargje me gogla; fletëpalosje për të lidhur numrin me sasinë; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta pikture; monedha të përgatitura vetë etj.

			nga jeta e përditshme e fëmijëve.	
<b>2. GJEOMETRIA DHE ORIENTIMI NË HAPËSIRË</b>	<b>2.1 Figurat dhe trupat gjeometrikë</b> <b>2.2 Marrëdhëniet hapësinore</b>	<p>- Figurat gjeometrike dydimensionale: katorri; trekëndori; rrëthori; drejtkëndori;</p> <p>- Trupat gjeometrikë tredimensionale: kubi; kuboidi; cilindri; sfera</p> <p>- Orientimi përvendndodhjen e objekteve në hapësirë, duke përdorur termat: para – pas; poshtë – lart; mbi – nën; etj.</p> <p>- Orientimi përdorur termat: para – pas; poshtë – lart; mbi – nën; majtas - djathtas etj.</p>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të emërtojë figurat gjeometrike dydimensionale: katorri; trekëndori; rrëthori; drejtkëndori</li> <li>• Të krijojë figurat gjeometrike dydimensionale: katorri; trekëndori; rrëthori; drejtkëndori, nëpërmjet vizatimit me dorë të lirë, prerjes më gëershërë, palosjes duke përdorur materiale të ndryshme (fije shkrepse; shkopinj etj)</li> <li>• Të gjejë forma ose pjesë të tyre, të ngjashme me figurat gjeometrike dydimensionale dhe trupat gjeometrikë tredimensionale, që gjenden në mjeshtirës.</li> <li>• Të emërtojë trupat gjeometrikë tredimensionalë: kubi; kuboidi; cilindri; sfera</li> <li>• Të përshkruajë vendndodhjen e një objekti, duke ju referuar një objekti</li> </ul>	Petëza; tabela manjetike;; kutime forma të ndryshme; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta picture, monedha të përgatitura vetë, figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndryshme; trupa gjeometrikë; mjete rrëthanore; fije shkrepse; shkopinj didaktikë; etj.

			<p>tjetër ose vetes së tij dhe duke përdorur fjalë të jetës së përditshme (para - pas; poshtë – lart; mbi – nën; afër – larg etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lëvizin në drejtime të caktuara, duke u orientuar nga fjalët (para; drejt; majtas; djathtas; prapa derës; afër karriges; nën tavolinë; etj).</li> </ul>	
<b>3. MATJA</b>	<b>3.1 Gjatësia</b> <b>3.2 Masa</b> <b>3.3 Koha</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mënyra të thjeshta të matjes së gjatësisë dhe të peshës.</li> <li>- Përdorimi i terminologjisë: më i gjatë se; po aq i gjatë ...; më i shkurtër se.</li> <li>- Klasifikimi sipas gjatësisë, volumit, peshës dhe lartësisë</li> <li>- Renditja sipas gjatësisë, volumit, peshës dhe lartësisë.</li> <li>- Përdorimi i terminologjisë: më i rëndë se; po aq i rëndë; më i lehtë se....</li> <li>- Përdorimi i kalendarit</li> <li>- Dita; java; muaji; viti dhe</li> </ul>	<p>Fëmija të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kryejë matje të gjatësive me njësi jostandardë (hapi; pëllëmba; libri; shirita letre etj.)</li> <li>• Të krahasojë masat e sendeve duke përdorur njësi jostandardë (mollë; laps; libra; lodra; peshore lodër etj.) dhe shprehjet : më i rëndë se; po aq i rëndë; më i lehtë se.... (p.sh çanta është më e rëndë se sa molla etj.)</li> <li>• Të krahasojë gjatësitë e sendeve, duke përdorur terminlogjitë: më i gjatë se, po aq i gjatë sa...; më i</li> </ul>	<p>Petëza; tabela manjetike;; kuti me forma të ndryshme; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta picture;; monedha të përgatitura vetë, figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndrsyhme; trupa gjeometrikë; mjete rrethanore; fije shkrepëse; shkopinj didaktikë; peshore lodër etj.</p>

	<p>stinët.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fjalët që tregojnë kohë: në mëngjes; në drekë etj.</li> <li>- Renditja e ngjarjeve brenda një dite</li> <li>- Lidhja e ngjarjeve me një kohë të caktuar (ditë; javë; muaj; stinë)</li> </ul>	<p>shkurtër se...;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të krahasojë sipas madhësisë sende dhe objekte duke përdorur fjalët: më i madh; më i vogël; më i lartë; më i ulët; etj.</li> <li>• Të klasifikojë sendet sipas gjatësisë; peshës; volumit dhe lartësisë.</li> <li>• Të renditë sendet dhe objektet sipas gjatësisë; peshës; volumit dhe lartësisë.</li> <li>• Të renditë fjalët që tregojnë kohën sipas rrjedhës së saj: mëngjes; drekë; mbasdite; mbrëmje; natë.</li> <li>• Të renditin ditët e javës; muajt e viti dhe stinët.</li> <li>• Të renditë ngjarje të ndryshme të një dite (ardhja në kopsht; ngrënia e mëngjesit; lojë etj.)</li> <li>• Të shoqërojnë veprimet me fjalët që tregojnë kohën e veprimit: në mëngjes; në drekë; mbasdite; në mbrëmje; natën; dje; sot; nesër; etj.</li> <li>• Të tregojë ngjarje që lidhen</li> </ul>	
--	--	---	--

			me ditë të caktuara të javës; muajve dhe të stinëve (p.sh. të hënën shohim filmin në kopsht; në maj kam ditëlindjen; etj.)	
<b>4. MODELE, MARRËD HËNIE DHE FUNKSIO NE</b>	<b>4.1 Modele dhe krahasime të tyre 4.2 Cilësitë e përbashkëta të elementeve të një grupi tij</b>	- Modelime sipas një rregulli të caktuar - Krahasimi i modelimeve të ndryshme - Klasifikimi i sendeve sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta	Fëmija të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Vazhdojnë renditjen duke zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës, madhësisë; volumit; peshës; gjatësisë.</li><li>• Të klasifikojnë grupe sendesh sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta.</li><li>• Të krahasojnë një model me një tjetër, sipas rregullit të ndërtimit të tyre (p.sh. ndryshimi në ngjyrë; në renditjen e formave; në renditjen e madhësive, peshave, gjatësive, etj)</li></ul>	Grupe sendesh, objektesh, letra formati, lapsa, lapustila, lapsa me ngjyra, kavaleta pikture etj.
<b>5. MBLEDHJ A E TË DHËNAVE</b>	<b>Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënavë</b>	- Evidentimi i të dhënavë - Grumbullimi i të dhënavë - Leximi i tabelave me të dhëna	Fëmija të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të grumbullojnë të dhëna për veten e tyre, shokët dhe nga mjedisi rrethues</li></ul>	Grupe sendesh, objektesh, letra formati, lapsa, lapustila, lapsa me ngjyra, tabela për regjistrimin e të dhënavë etj

			<p>(10 fëmijë e kanë ditëlindjen në korrik, 3 në qershor, 2 në maj etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Lexon tabelat e grumbullimit të të dhënavë (p.sh. për javën: 3 ditë me shi; 2 ditë me re; 1 ditë me diell dhe 1 ditë me erë)</li></ul>	
--	--	--	--	--



# PROGRAMI I ZHVILLIMIT SHKENCOR

## PËR GRUPIN E FËMIJËVE 5-6 VJEÇ NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

### 1. HYRJE

Standardet e parashkollarit theksojnë në përdorimin e njohurive, aftësive bazë shkencore për të eksploruar materiale të ndryshme, objekte dhe gjalesa. Nxënësit priten të zhvillojnë aftësitë e tyre duke bërë pyetje të thjeshta, matje, ndarje, klasifikime dhe duke shkëmbyer informacionin rreth botës që i rrethon. Njohuritë shkencore kanë një rëndësi të veçantë për atë që nxënësi mëson rreth proceset jetësore dhe për vetitë e materialeve të familjarizuara si uji, magneti. Nëpërmjet fenomenit të ditë-natës, stinëve të vitit, ritjes së bimëve, nxënësit do të prezantohen me konceptin e ndryshimit kuptimi për burimet natyrore dhe ruajtja janë prezantuar në standardet e parashkollarit.

### 2. LINJAT KURRIKULARE

#### Përbajtja sipas linjave:

##### A. INVESTIGIMI SHKENCOR, ARSYETIMI DHE LOGJIKA

A.1. Nxënësi do të mësohen me vëzhgimin në mënyrë të tillë që:

- Cilësitë bazë të objekteve të identifikohen nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë;
- Vëzhgimet të kryen nga pozicione të ndryshme për të pasur këndvështrime të ndryshme;
- Seti i objekteve është seri në lidhje masën
- Seti i objekteve është i ndarë në dy grupe duke u bazuar në një veçori fizike;
- Grafikët, figurat janë ndërtuar dike përdorur jo më shumë se 10 njësi.
- Njësitë jo standarde përdoren për të matur shumë objekte
- Një çështje të zhvillohet nga një ose më shumë vëzhgime.
- Të Njihen rezultat e papritura dhe të pazakonshme;

A.2. Nxënësit do të investigojnë dhe të kuptojnë që qeniet njerëzore kanë shqisa, ndjesi duke përfshirë të parin, nuhatjen, dëgjim, prekje, shije. Shqisat mundësojnë të kërkosh, gjesh, të marrësh duke iu përgjigjur informacionit në mënyrë të tillë për të mësuar rreth vetes e botës që të rrethon.

Konceptet kyç përfshijnë:

- Pesë shqisat (të shijuarin, të prekin, të nuraturin, të dëgjuarin dhe të shikuarit);
- Organet e shqisave shoqërohen me organin përkatës (sytë, veshët, hunda, gjuha, dhe lëkura);

- përshkrimi I ndjesive (e ëmbla, tharta, hidhura, kripura, e ashpra e lëmuara, e fortë e butë, ftohtë, ngrohtë, I zhurmshëm – I qetë butë, lart-poshtë, I ndritshëm, I turbullt

## B. FORCA, LËVIZJA DHE ENERGJIA

B. Nxënësit do të vëzhgojnë dhe do të kuptojnë që magnetet veprojnë në disa materiale, duke I bërë ato të lëvizin pa I prekur dhe kanë një zbatim shumë të përdorshëm.

Konceptet bazë përfshijnë:

- Manjetizim/ jomanjetizim (tërheqje /jo tërheqje), shtytje/tërheqje, tërheq/largon dhe metal/jometal,
- Aplikime të përdorshme (ftohës manjetik, thyesh akulli, magnetizëm)

## C. MATERIALET

C.1. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që objektet mund të përshkruhen në bazë të veçorive të tyre fizike.

Konceptet bazë përfshijnë:

- Tetë ngjyrat bazë;
- Figurat (rreth, trekëndësh, katror) dhe format (fleksibël, fortë, drejtë e harkuar)
- Përzierjet dhe ndjesitë e ashpër, e lëmuar, fortë butë,);
- Masa relative dhe pesha( i madh I vogël, I gjërë, I ngushtë, e rëndë e lehtë, e hollë, e gjatë, shkurtër,
- Pozicioni dhe shpejtësia(sipër, poshtë, Brenda jashtë, majtas djathtas shpejt ngadalë
- Forma në vazhdim katrori, rrathi, rombi ovale.

C.2. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që uji ka veti që e bëjnë të dallohet dhe të shijohet .

- uji merr forma të ndryshme (lëng, gaz, i ngurtë)
- rënia natyrale e ujit është shiu
- disa materiale notojnë qëndrojnë sipër ujit ndërsa disa zhyten

## D. PROCESET JETËSORE

D.1. Nxënësi do të investigojë dhe të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të bimëve dhe të kafshëve.

Konceptet kryesore:

- Gjallesat ndryshojnë ashtu si rriten kanë nevojë edhe për ushqim, ujë, ajër për të mbijetuar;
- Bimet dhe kafshët jetojnë dhe vdesin( fillimi e mbarimi I një cikli jetësor)
- Pasardhësit e bimëve dhe të kafshëve janë të ngashëm por jo identik me prindërit e tyre dhe të tjerëve
- Identifikimi nëpërmjet emrit I prindit dhe pasardhësit.

## E. NDËRMARRËDHËNIA NË TOKË, HAPËSIRË DHE SISITEM

*E.1. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që hija ndodh , vjen si rezultat kur drita është e bllokuar nga një object.*

Konceptet kryesore:

- Hija ndodh në natyrë kur drita e diellit është e bllokuar nga një object;
- Hija mund të prodhohet nëpërmjet bllokimit të dritës artificiale.

## F. NDRYSHIMET DHE CIKLI JETËSOR

*F.1. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë shembuj të thjeshtë, prototype, nga jeta e tij e përditshme*

Konceptet kryesore:

- Vëzhgimi I motit;
- Format dhe përmasat e ndryshme të shumë objekteve natyrore duke përfshirë farërat, boçë, gjethet;
- Rritjen e kafshëve dhe të bimëve;
- Rutina shkollë-shtëpi;
- Katër stinët;
- 12 muaj bëjnë vitin;
- 7 ditë bëjnë javën.

*F.2. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që ndryshimet ndodhin vazhdimisht dhe shpejtësia e tyre mund të jetë e ndryshme si:ngadalë, shpejt*

Konceptet kryesore:

- sendet natyrale dhe të bëra nga dora e njeriut mund të ndryshojnë herëpas here, vazhdimisht;
- Ndryshimet mund të njihen, shikohen, dhe mund të maten.

## G. BURIMET

*G.1. Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund ripërdoren, riciklohen, dhe të ruhen, konservohen.*

Konceptet kryesore:

- Identifikim materialesh dhe objektesh që ripërdoren herë pas here;
- Përshkrimi materialeve të jetës së përditshme që ricklohen;
- Shpjegimi sesi të ruajmë ujin dhe energjinë në shtëpi dhe në shkollë.

## 3. Karakteristikat e nxënies në këtë moshë, për shkencat shoqërore

- Kuptojnë që gjendja e mjedisit ndikon në shëndetin e njeriut dhe të ndjejnë nevojën e një mjedisi të shëndetshëm.
- Kujdesen për gjallesat dhe mjedisin që i rrëthon.
- Japin shpjegime elementare për dukuritë, proceset natyrore dhe zbatimet e thjeshta teknike.
- Interpretojnë informacione të thjeshta, të dhëna në mënyrë vizuale dhe të shkruar.

- Njohin teorikisht bazën materiale, proceset e punës dhe teknikat në realizmin e një punimi.
- Vëzħgojnë elementet në një punim apo krijim.
- Përshkruajnë dhe interpretojnë karakteristikat e punimit të kryer.

#### **4. MATERIALE DIDAKTIKE**

- Gérshérë me majë të rrumbullakët, të vogla dhe të mesme
- Vizore me gjatësi 20 cm.
- Trekëndësh
- Kompas të thjeshtë
- Furça për lëndën ngjitëse
- Letër vizatimi e bardhë, që nuk griset lehtë
- Letër me ngjyrë: e kuqe, e kaltër, e verdhë etj.
- Lapsa, lapsa të butë vizatimi
- Pastela (të paktën 8 ngjyra)
- Shenjues me ngjyra të ndryshme
- Bojëra, bojëra uji, tempera
- Ngjitës
- Argjilë, plastelinë
- Shkumësa me ngjyra
- Pineska
- Shirit mbulues
- Mjete për të punuar me argjil
- Gjilpëra për qepjen e copave, letrave etj.

***Materiale për mësuesin:***

- Kapëse letre
- Vizore
- Gérshérë me majë të mprehtë
- Hapëse vrimash në letër
- Makinë për lidhjen e letrës dhe kapëse
- Shirit mbulues
- Pineska
- Mjete për pastrim
- Sfugjer
- Copa të ndryshme
- Prerës letre
- Enë uji

***Materiale të mbledhura me ndihmën e prindërve.***

- Letër të vjetër
- Kanaçe
- Lloje të ndryshme letrash (karton, letër higjenike, letër gazete)
- Copa bezesh (pambuku, leshi)

- Copa druri
- Kopsa
- Penj, spango, shirit
- Fije kashte
- Boçe pishe
- Guacka
- Gjilpëra me kokë, kapëse (rrobash)
- Piktura të riproduara, kartolina, fotografi revistash
- Shkopinj, dru
- Këmisha pune, përparëse
- Enë uji etj.

## 5. PROGRAMI I DETAJUAR SIPAS LINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE

ZHVILLIMI SHKENCOR		
Linjat	Objektivat e nxënies	Konceptet bazë
<b>A. INVESTIGIMI SHKENCOR, ARSYETIMI DHE LOGJIKA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit do të mësohen me vëzhgimin</li> <li>• Nxënësit do të vëzhgojnë dhe të kuptojnë që qeniet njerëzore kanë shqisa, ndjesi duke përfshirë të parin, nuhatjen, dëgjim, prekje, shije.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pesë shqisat</li> <li>• Organet e shqisave</li> <li>• Përshkrimi I ndjesive</li> </ul>
<b>B. FORCA, LËVIZJA Dhe ENERGJIA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit do të vëzhgojnë dhe do të kuptojnë që magnetet veprojnë në disa materiale, duke l bërë ato të lëvizin pa l prekur dhe kanë një zbatim shumë të përdorshëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Manjetizim/ jo manjetizim</li> <li>• metal/jometal,</li> </ul>

<b>C. MATERIALET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që objektet mund të përshkruhen në bazë të veçorive të tyre fizike.</li> <li>• Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që uji ka veti që e bëjnë të dallohet dhe të shijohet .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngjyrat bazë;</li> <li>• Figurat (rreth, trekëndësh, katror)</li> <li>• Format (fleksibël, fortë, drejtë e harkuar)</li> <li>• ndjesitë (e ashpër, e lëmuar, fortë butë,);</li> <li>• Masa relative dhe pasha ( i madh I vogël, I gjërë, I ngushtë, e rëndë e lehtë, e hollë, e gjatë, shkurtër,</li> <li>• Pozicioni dhe shpejtësia(sipër, poshtë,</li> <li>• Brenda jashtë, majtas djathtas shpejt ngadalë</li> <li>• uji merr forma të ndryshme (lëng, gaz, i ngurtë)</li> <li>• shiu</li> <li>• disa materiale notojnë qëndrojnë sipër ujit ndërsa disa zhyten</li> </ul>
<b>D. PROCESET JETËSORE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi do të investigojë dhe të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të bimëve dhe të kafshëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjallesat ndryshojnë</li> <li>• Cikli jetësor</li> <li>• Pasardhësit</li> <li>• Të ngjashëm /identik</li> <li>• Identifikimi nëpërmjet emrit</li> </ul>
<b>E. NDËRMARRË DHËNIA NË TOKË, HAPËSIRË DHE SISITEM</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që hija ndodh , vjen si rezultat kur drita është e bllokuar nga një objekt.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hija natyrale</li> <li>• Hija artificiale.</li> </ul>

<b>E. NDRYSHIMET DHE CIKLI JETËSOR</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë shembuj të thjeshtë, prototipe, nga jeta e tij e përditshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vëzhgimi i motit;</li> <li>Format dhe përmasat e ndryshme</li> <li>Rritja e kafshëve dhe të bimëve;</li> <li>Rutina shkollë-shtëpi;</li> <li>Katër stinët;</li> <li>12 muaj e vitit;</li> <li>7 ditë e javës.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që ndryshimet ndodhin vazhdimesht dhe shpejtësia e tyre mund të jetë e ndryshme si:ngadalë, shpejt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>sendet ndryshojnë herëpas here, vazhdimesht;</li> <li>Ndryshimet mund të njihen, shikohen, dhe mund të maten.</li> </ul>
<b>F. BURIMET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësi do të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund ripërdoren, riciklohen, dhe të ruhen, konservohen.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikim materialesh</li> <li>Përshkrimi materialeve</li> <li>Ruajmë ujin dhe energjinë në shtëpi dhe në shkollë.</li> </ul>

## **PROGRAMI I SHKENCAVE SOCIALE**

### **PËR GRUPIN E FËMIJËVE 5-6 VJEÇ NË ARSIMIN PARASHKOLLOR**

#### **1. HYRJE**

Programi i shkencave sociale presupozon të jetë një kornizë e mësimit të gjeografisë dhe shkencave sociale. Studiuesit e moshës parashkollore besojnë se fëmijët duhet të njojin fillimisht botën e më pas të lëvizin drejt të kuptuarit rajonal. Një ushtrim i thjeshtë në gjeografi mund të përfshijë globin prej letre apo prej rëre. Në këtë mënyrë fëmijët mund të ndjejnë globin dhe eksperiencën e formimit të kontinenteve. Ata fitojnë të kuptuarin që Toka është e përbërë nga uji (i butë dhe blu) dhe toka (e ashpër dhe kafe). Librat, pikturat në mure dhe materiale të tjera përdoren për të ndihmuar fëmijët që të fitojnë njohuri rreth botës. Duke e çuar fëmijën drejt koncepteve globale, punën me harta ndërhyhet në kontinentet, vendet, kafshët dhe njerëzit e botës.

Fëmijët gjithashtu gjelqojnë, mësojnë dhe zhvillojnë vetëvlerësimin duke biseduar rreth gjërave që janë të lidhura ngushtë me jetën e tyre si familjet, miqtë dhe kafshët shtëpiakë. Mësuesit u japid mundësi atyre gjatë vitit për të ndarë përvojat personale dhe për të lidhur jetën e tyre në shtëpi me atë në kopsht. Një gjë e tillë mund të bëhet në shumë mënyra, si p.sh. t'u kërkohet fëmijëve të sjellin në kopsht fotografitë e familjes ose të ditëlindjeve (një për secilin vit të jetës së fëmijës). Letërsia dhe librat me figura janë gjithashtu të vlefshme për të njojur tipet e ndryshme të familjeve dhe të stileve të jetesës.

Kopshti i ofron një komunitet fëmijës që e ndjek atë. Me ndihmën e shumë materialeve, fëmijët mësojnë të kujdesen për mjedisin dhe fillojnë të kuptojnë rolin e tyre në komunitetet ku bëjnë pjesë. Koha e punës gjatë çdo dite u jep atyre përgjegjësinë e përkujdesjes dhe krenarinë e pronësisë së kopshtit apo grüpuit të tyre. Në moshën 5-6 vjeçare, koncepti i komunitetit shtrihet përmes grüpuit, ai përfshin pjesë të tjera të kopshtit. Për shembull, këtu bëjnë pjesë mbledhja e kuzhinierit, e administratorit, e shokëve të grupeve të tjera dhe e mësuesve.

#### **2. EDUKIMI SHUMË-KULTUROR**

Kopshtet tona janë të angazhuar për programe shumë-kulturore. Edukimi shumë-kulturor nuk është i mbështetur nga një fushë e vetme e kurrikulës, por e të gjitha fushave kurrikulare që janë pjesë e edukimit ditor. Mësuesit e dinë që fëmijët mësojnë vlerat e diversitetit së bashku me mësimin e kulturave të tjera të shprehura në qëndrimet dhe sjelljet që i shoqërojnë ata çdo ditë. Duke e njojur këtë fakt, mësuesit duhet të vlerësojnë me kujdes paraqitjen e tyre, po aq sa mjedisin e plotë të grüpuit.

Një mënyrë e përshtatshme në të cilin paraqitet diversiteti kulturor në grup është nëpërmjet imazheve që prezantohen çdo ditë. Kukullat dhe lodrat e tjera që u paraqiten fëmijëve ose familjeve të tyre janë njerëz nga etni, gjini dhe mosha të ndryshme. Tablotë e vendosura për dekorim, festa ose si pjesë e fushave të tjera kurrikulare mund të përfshijnë variante nga tradita në mënyrë që të demonstrohen një shkallë e gjerë zgjedhjesh. Leximet përzgjidhen për të reflektuar pasurinë etnike dhe kulturore. Fëmijët dëgjojnë muzikë nga

gjithë bota dhe këndojnë këngë në gjuhë të ndryshme. Fëmijët mund të përdorin objekte, para ose lodra që ju dhurohen nga të afërmit e tyre që udhëtojnë në vende të ndryshme. Mësuesit mund të përdorin si mundësi prezantimi të një vendi tjetër në gjeografi ose shkencat sociale duke marrë shkas udhëtimin e ndonjë fëmije të grupit.

Që të ndihmohen fëmijët për të vlerësuar zakonet e ndryshme, mund të organizohen lloje të ndryshme festash. Gjatë dimrit, p.sh mund të festohen Krishtlindjet dhe solstici dimëror. Festa e pranverës, viti i ri kinez dhe festivalë të tjera kulturore mund të janë pjesë e dijes së fëmijëve. Nuk janë pushimet verore ose dimërore vetëm një aspekt i përvojës kulturore; mësuesit duhet të sigurojnë që trajtimi shumë-kulturor nuk ndodh në izolim, por vazhdon gjatë gjithë vitit në kurrikulën e shkencave sociale.

### **3. EDUKIMI SOCIAL - EMOCIONAL**

Kurrikula social- emocionale është një komponent integral i programit parashkollor. Mësuesit krijojnë mjedisin që mbështet rritjen sociale dhe emocionale të çdo fëmije. Fëmija është i inkurajuar të ketë besim te mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tij, ndërkohë që bëhet me vetëbesim dhe autonom. Mësuesit u japin mundësi fëmijëve të flasin dhe të shprehin veten në mënyra sociale të pranueshme. Mësuesit vlerësojnë dhe mbështesin idetë dhe ndjenjat e tyre. Gjatë kursit të parashkollorit, fëmija rritet me kapacitetet e tij sociale dhe emocionale.

Si një parashkollar, fëmija mëson të bëjë zgjedhje për veten dhe të mësojë mënyra se si të bëhet pjesë e grupit. Ndarja nga prindërit e tij është një element domethënës në fitimin e pavarësisë. Mësuesi bëhet një ndërlidhës i rëndësishëm në këtë tranzicion nga shtëpia dhe prindërit ndërkohë që fëmija zhvillon besimin te të rriturit e tjerë, krahas kujdestarëve të tij të parë. Pasi fëmija fillon të bëhet gjithnjë e më shumë i pavarur, ai mëson për rregullat, rutinat dhe pritet e grupit ku bën pjesë. Kjo përfshin pritet e radhës nga ai, njojhen e agjendës ditore, uljen në rreth, ngritjen e dorës kur dëshiron të flasë dhe shëtitjen në rresht. Fëmija fillon të zbulojë që pasojat janë natyrale dhe logjike në se ai nuk përbush atë çka pritet prej tij.

Fëmija gjithashtu mëson të ketë kujdes për veten dhe mjedisin rreth tij. Shumë studiues besojnë se në se i japim fëmijës një model ose një mjet të përshtatshëm, çdo fëmijë mund dhe duhet të bëjë vetë gjithçka që është i aftë të bëjë. Në klasë, kjo manifestohet përmes të qenit të përgjegjshëm për veten si p.sh me larjen e duarve dhe të veshurin vetë, kujdesin për mjedisin si pastrimin e tryezës së vet, fshirjen e pluhurave, ujitjen e luleve dhe larjen e pasqyrave. Nga fëmija gjithashtu pritet të thotë faleminderit dhe të jetë i sjellshëm. P.sh ai inkurajohet të shtyjë karrigen e tij për ta vënë pranë tryezës, të vendosë materialet në vendin e vet pasi ka mbaruar punë dhe të thotë të lutem dhe faleminderit kur nevojitet.

Bërrja e miqve është një aftësi e rëndësishme sociale që fëmija fillon ta mësojë në parashkollar dhe ta vazhdojë gjatë gjithë jetës. Ai mëson se si të ndajë materialet dhe të praktikojë marrjen dhe dhënien. Kur ka një konflikt me bashkëmoshatarët, atij i duhet dhënë një mjet për ta zgjidhur këtë konflikt, së pari me udhëheqjen e mësuesit dhe më vonë, nëpërmjet ndërhyrjes së një rrituri. Mësuesit përdorin një shumëlojshmëri metodash të tillë si Loja me role dhe kukulla për të ndihmuar fëmijët të identifikojnë problemin dhe për

të gjetur zgjidhjen që i kënaq të gjithë të përfshirët në konflikt. Gradualisht, parashkollori mëson gjuhën e përfshirjes që konsiston në ftesën që i bëhet dikujt për të hyrë në lojë, në vlerësimin e interesave të tij për t'u bashkuar në grup dhe për të përfshirë fëmijët e tjerë në lojën e grupit. Fëmija provon në shumicën e rasteve shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij. Mësuesit bisedojnë rrëth ndjenjave që ata shprehin, lexojnë libra rrëth emocioneve dhe japid modelin e fjalorit që i shpreh ato. Në kthim, fëmijët mësojnë të lexojnë shprehjet e fytyrës dhe të trupit, bisedojnë rrëth ndjenjave të tyre në termat e përvojave të tyre dhe bëjnë një libër ndjenjash.

Një aspekt esencial i kurrikulës së shkencave sociale është njohja e nevojës së fëmijës për kontroll dhe mjeteve që i jepen atij për të shprehur veten në mënyrë të përshtatshme. Fëmija është duke mësuar aftësi dhe ndihet kompetent kur është i suksesshëm me materialet dhe aktivitetet. Ai fiton role të ndryshme, bashkërisht udhëheqës dhe ndjekës në lojëra dhe aktivitetet. Mësuesi gjithashtu jep punë të ndryshme në klasë për t'i dhënë fëmijës mundësi të ndihet i plotfuqishëm.

Pasi fëmija bëhet i ndërgjegjshëm dhe me besim në aftësitë dhe shprehitë e tij, ai bëhet një udhëheqës për bashkëmoshatarët e tij dhe shokët e grupit. Ai modelon sjellje të përshtatshme në klasë dhe përpinqet të ndihmojë fëmijët më të vegjël të kopshtit në aktivitetet të ndryshme të klasës. Duke u bërë një anëtar përgjegjës i komunitetit, ai zhvillon dhe demonstron kujdesin për të tjerët dhe bën mediatorin për konfliktet e bashkëmoshatarëve.

Kurrikula e shkencave sociale ka një peshë të konsiderueshme në parashkollar. Fëmija zhvillon një sens të besimit dhe të iniciativës brenda kontekstit të marrëdhënieve me mësuesit e tij.. Në përfundim, mësuesit ofrojnë aktivitete që mbështesin besimin tek vetja dhe respektin për të tjerët.

#### 4. LINJAT KURRIKULARE

Kurrikula e studimeve shoqërore për nivelin e parashkollorit fokusohet në dhënien e ndihmesës për zhvillimin e ndërgjegjimit të vetes si një rritje të personalitetit. Ata mësojnë rrëth vlerave, ideve, zakoneve dhe traditave nëpërmjet përralave të folklorit populor, legjendave, këngëve dhe historive gojore. Në vazhdim, si rrjedhojë marrdhëni e fëmijëve me të tjerët në mjeshterin shkollor bëhen burim nxënjeje për studimet shoqërore. Aftësitë interactive, ndërvepruese sociale janë pjesë e programit të parashkollorit. Fëmijët gjithashtu gjithashtu mësojnë për rolin e tyre si qytetar duke pranuar të drejtat dhe përgjegjositë në klasë dhe duke mësuar për rregullat dhe ligjet.

#### Përbajtja sipas linjave:

##### Vetja ime dhe të tjerët

- Të gjithë njerëzit kanë ngashmëri dhe ndryshime.

##### Familja ime dhe e të tjerëve

- Të gjithë familjet kanë ngashmëri dhe ndryshime

##### Shkolla ime dhe shkolla e komunitetit

- Çfarë është shkolla?

##### Vendndodhja e shtëpisë, shkollës, lagjes dhe komunitetit në hartë dhe në glob

- Fushat, malet dhe detet në hartë dhe glob (siapas ngjyrave).

## Dëshirat dhe Nevojat bazë të njerëzve

- Të gjithë njerëzit kanë nevoja dhe dëshira.

## Njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin për plotësimin e nevojave dhe dëshirave

- Njerëzit besojnë, mbështeten, (bashkëpunojnë me) te njëri-tjetri për të mirat dhe shërbimet.

## Simbolet e qytetarisë

- Qytetaria përfshin një ndërgjrgsim për simbolet kombëtare, Të kuptuarin e festave dhe të përvjetorëve, të kuptuarit e respektit për flamurin kombëtar.

## Të drejtat dhe përgjegjsitë e roleve të qytetarisë

- Të gjithë njerëzit kane Të drejta dhe përgjegjsi në shtëpi, shkollë dhe në komunitet.

## Njerëzit bëjnë dhe ndryshojnë ligjet

- Njerëzit bëjnë dhe ndryshojnë rregullat, ligjet, për shumë arsy, dhe ato kanë efekt për të gjithë të tjerët.

## 5. Karakteristikat e nxënies në këtë moshë, për shkencat shoqërore

- Kuptojnë dhe analizojnë veprimet e tyre dhe të shokëve, si dhe ndikimin reciprok të tyre;
- Kuptojnë rolin e të drejtave dhe të detyrave të tyre;
- Kuptojnë si ushtrohen rregullat në jetën e përditshme;
- Bashkëpunojnë në grup, duke dëgjuar dhe respektuar mendimin e shokut, duke u aftësuar për të zënë një pozicion dhe për të përdorur një sasi më të madhe informacioni apo baze materiale;
- Punojnë të pavarur gjatë një detyre, për të marrë përgjegjësi për punën që bëjnë;
- Japin shpjegime për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tyre dhe të tjerëve;
- Dallojnë të vlerësojnë nevojën që kanë për njerëzit dhe mjedisin që e rrëthon;
- Dallojnë rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri (në familje, klasë, grup, lagje etj.).
- Bashkëpunojnë me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë.
- Njohin rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor.

## 6. PROGRAMI I DETAJUAR I FORMIMIT SOCIAL, SIPAS LINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE

<b>Zhvillimi Personal, Social, dhe Emocional</b>		
<b>Linjat</b>	<b>Objektivat e nxënieve</b>	<b>Konceptet bazë</b>
1. RREGULLAT DHE QËNDRIMET	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e pavarësisë duke treguar kujdes për zgjedhjen e veprimtarive dhe funksionimin e tyre.</li> <li>• Shfaqja e konfidencës me të tjerët për bashkëpunim dhe drejtim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulla</li> <li>• Qëndrim</li> <li>• Bashkëpunim</li> <li>• Drejtim</li> <li>• Përzgjedhje</li> <li>• Afrimitet</li> </ul>
2. VETËSIGURIA DHE RESPEKTI PËR VETEN	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaqja e ndjenjës së përkatësisë</li> <li>• Të treguarit kujdes dhe shqetësim për veten</li> <li>• Të folurit lirshëm për shtëpinë dhe komunitetin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përkatësi</li> <li>• Vetësiguri</li> <li>• Respekt</li> <li>• Shtëpi</li> <li>• Shkollë</li> </ul>
3. KRIJIMI I MARRËDHËNIEVE	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i marrëdhënie me anëtarët e grupit</li> <li>• Demonstrimi i fleksibilitetit dhe të përshtaturit e sjelljes në situata të ndryshme sociale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrëdhënie</li> <li>• Anëtarësim</li> <li>• Përshtatje</li> </ul>
4. SJELLJA DHE VETËKONTROLI	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të treguarit kujdes dhe shqetësim për të tjerët, për gjallesat dhe mjedisin.</li> <li>• Ndërgjegjsim për kufizimet dhe të përshtaturin e të sjellurit me to.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëkontroll</li> <li>• Sjellje</li> <li>• Shqetësim</li> <li>• Ndërgjegjsim</li> <li>• Kufizim</li> </ul>
5. VETËKUJDESI	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndërmarrurit e iniciativave duke realizuar kërkesat përkatëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Iniciativë</li> <li>• Vetëkujdes</li> <li>• Kërkesë</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaqja e fortë e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunitet</li> </ul>

6. NDJENJA E KOMUNITETIT	ndjenjës së komuniteti si një anëtar i komuniteteve të ndryshme (për shembull në familje, në shkollë)	• Nderkomunitet
--------------------------	---	-----------------

## 7. MATERIALE DIDAKTIKE

- **Postera**
- **Tabela të ndryshme**
- **Harta të qytetit dhe të komunitetit**
- **Fletore vizatimi**

## 8. UDHËZIME DIDAKTIKE

Njohuritë psiko-pedagogjike, takti pedagogjik, marrëdhëniet me fëmijët, prindërit dhe komunitetin përbëjne themelin e kompetencës profesionale, cila nuk arrihet me mbarimin e shkollës së mesme dhe as me mbarimin e shkollës së lartë, por vazhdon gjatë gjithë jetës, nëpërmjet studimit individual dhe veprimtarisë kualifikuese.

*Mos harroni se, të gjitha këto vështirësi ju mund t'i përballoni vetëm në rast se krijoni bindjen se ju i doni dhe i respektoni fëmijët. Do t'i lejoni vetes një gabim të pafalshëm në rast se e ushtroni këtë profesion pa i dashur fëmijët. Në rast se kjo është e vërtetë, ju, pa dashur, dëmtoni mendërisht dhe fizikisht fëmijët tuaj.*

Sot, të mësuarit e fëmijëve nuk konceptohet më si proces i transmentimit të njohurive nga ana e mësueses dhe përvetësimit nga ana e parashkollorëve, por si një proces kërkimi dhe bashkëpunimi i fëmijëve me njëri-tjetrin, dhe me të rriturit që i rrëthojnë, proces që gjithnjë udhëhiqet nga mësuesja. Fëmija, që nga natyra ka dëshirë të rritet dhe të mësojë, është subjekt dhe objekt aktiv i procesit edukativo – mësimor, dhe vendoset në qendër të këtij procesi.

Megjithëqë zhvillimi i fëmijës kushtëzohet nga trashëgimia dhe mjeti social e kulturor, ai është aktori kryesor i zhvillimit të vet, i aftë të ndërveprojë më të rriturit dhe bashkëmoshatarët. Është detyra e mësueses të vëzhgojë marrëdhëniet fëmijë-fëmijë, dhe të nxisë mendimin e parashkollorëve; të marrë pjesë në veprat e barabartë me ata; t'i nxisë ata të komunikojnë me njerëzit që i rrëthojnë.

Ndërveprimi midis fëmijëve është dëshirë dhe nevojë që duhet t'ju plotësohet nëpërmjet krijimit të situatave të favorshme.

Vetëmësimi dhe bashkëmësimi, që zhvillohet në grupe të vogla të fëmijëve me ndihmën e të rriturit, realizojnë organizimin e mendimeve, ideve dhe veprimeve të fëmijëve.

Bashkëveprimi i fëmijëve evidenton, shumëfishon dhe përsos sjelljet sociale, emocionale, komunikuese dhe njohëse. Fëmijët që punojnë në grup arrijnë rezultate të larta, që fëmijët e vetmuar vështirë se mund t'i arrijnë.

Shumë aspekte të karakterit të fëmijës ndikojnë në zhvillimin e tij dhe në jetën sociale. Të tillë janë aftësia e shoqërizimit, e përqendrimit, e të mësuarit nga gabimet vetjake, e të

punuarit, të vëzhguarit. Ndërsa aspektet më pak favorizuese janë ato që e bëjnë të jetë i hutuar, i ngadalshëm në të kuptuarit e gjërave, pak i përqendruar dhe kërkon të manifestojë pavarësinë, të mos bindet dhe të bëjë gjithçka që nuk duhet bërë.

#### Ja disa tipare të fëmijëve që shfaqen gjatë rritjes :

- Toleranca, qetësia dhe prirja për t'u përqendruar;
- ngacmueshmëria, prirja për të kundërshtuar vend e pa vend dhe për të komanduar bashkëmoshatarët;
- afroeshmëria, shoqërizimi, prirja për t'iu përshtatur të tjerëve;
- serioziteti, vendosmëria dhe
- pavarësia, kryeneçësia dhe kokëfortësia.

#### **Vajzat janë :**

- Shumë të shoqërueshme dhe preferojnë shoqërinë me djemtë;
- Më të prira të shoqërohen dhe të lidhin miqësi deri në fund tëfëmijërisë së hershme;
- Më përfillëse ndaj kërkeseve të të rriturve dhe
- Më pak kompetitive dhe, si rrjedhojë, më pak agresive e komanduese.
- Vajzat përballojnë më me lehtësi lodhjen fizike, intelektuale dhe emocionale.

#### **Sjellja e djemve :**

Niveli i shoqërizimit të djemve është më i ulët se i vajzave, pranohet se djemtë :

- Janë më të ngadaltë në zhvillimin e aftësive sociale;
- Janë më agresivë në grupin ku veprojnë;
- Kanë shumë miq, por lidhjet midis tyre janë sipërfaqësore dhe zgjatin pak kohë;
- Janë të prirë të kenë probleme në sjellje, veçanërisht në praninë e një personi me autoritet.

Detyra e prindërve është ta pranojnë fëmijën për atë që është, ashtu siç është, dhe ta ndihmojnë të shfrytëzojë sa më mirë potencialin e vet, por gjithnjë duke mos e sforcuar, duke e dashur dhe respektuar.

Në vendosjen e marrëdhënieve me prindërit, ndër detyrat e mësueses përmendim edhe:

- Fftesën e vazhdueshme drejtuar prindërve që të vijnë sa më shpesh në kopsht, të marrin pjesë në veprimtaritë që zhvillohen;
- Dhënien e informacionit për mbarëvajtjen e fëmijës. Mos harroni : Asnjë herë **prindëreve mos u vini në dukje dobësi të fëmijës në prani të njerëzve të tjerë.** Biseda të kësaj natyre bëhen gjithnjë kokë më kokë;
- Vizitat sistematike në shtëpitë e fëmijëve dhe
- dhënien e njohurive të nevojshme për t'i ndihmuar ata në punën edukative që duhet të bëjnë në shtëpi me fëmijën.

## PROGRAMI I EDUKIMIT ARTISTIK PËR GRUPIN E FËMIJËVE 5-6 VJEÇ NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

### I. Hyrje

Edukimi artistik në arsimin parashkollar për moshën 5 – 6 vjeçare **ka si qëllim** të aftësojë fëmijët e kësaj moshe për të kuptuar, kriuar dhe vlerësuar artet gjatë jetës. Ata mësojnë të zbulojnë veten dhe të shpjegojnë se *mendimet, ëndrrat* dhe *dëshirat* mund të shprehen jo vetëm me fjalë por edhe përmes arteve të tjera.

Edukimi artistik përbëhet nga katër linja apo drejtime: *vallëzimi, drama, muzika dhe arti figurativ*. Programet do të përbledhin jo vetëm të kriuarin dhe të studiuarin e arteve, por dhe rolin e tyre duke mësuar se si të përshtatin dhe t'u përgjigjen punëve të artit.

Veprimitaritë në edukimin artistik realizohen përmes pjesëmarrjes së vazhdueshme në këndim, në vizatim, në vallëzim, tregimin e apo interpretimin e një historie apo drame të vogël.

Në këtë fushë të gjitha veprimitaritë që kryhen përmes linjave, lejojnë dhe i jasin mundësi nxënësve të komunikojnë përmes paraqitjes vizuale, tingujve muzikorë, shprehjes dramatike, kërcimit, mjeteve audiovizive etj. Kështu fëmijët duke vizatuar imazhe të ndryshme, duke kënduar dhe dëgjuar muzikë, duke kërcyer, duke përdorur fjalë dhe gjeste mësojnë të shprehin emocionet dhe mendimet e tyre. Gjithashtu, kjo mënyrë e të shprehurit të vvetves i jep liri imagjinatës së tyre.

### II. LINJA, OBJEKTIVA DHE KONCEPTE

#### Drama

##### Synimet

☞ *Programi i dramës* për këtë moshë, ka si qëllim të sigurojë mundësinë për:

- Të zhvilluar aftësitë interpretative;
- Të zhvilluar aftësinë e komunikimit përmes gjuhës dhe veprimeve;
- Të forcuar njohjen e traditave kulturore dhe shoqërore;
- Të vlerësuar pjesë të ndryshme teatrale, përmes reflektimit apo qëndrimit kritik.

##### Objektivat

Përmes kuptimit dhe interpretimit të pjesëve të vogla teatrale nxënësit mësojnë:

- Të zbulojnë tema të ndryshme (të thjeshta) për t'i vënë në skenë;
- Të zhvillojnë të menduarin e tyre gjatë interpretimit;
- Të zgjidhin problemet që u dalin gjatë interpretimit;
- Të përdorin një gjuhë të thjeshtë fëminore;

- Të përdorin fantazitë e tyre në një pjesë teatrale;
- Të shpjegojnë sjelljen e personazheve të ndryshme dhe se si ndryshojnë ato;
- Të shpjegojnë se si funksionon dhe realizohet një vepër arti dramatik.

## Muzika

### Synimet

☞ *Programi i muzikës* për këto mosha ka si qëllim të përfshijë dhe të sigurojë një sërë përvojash të cilat drejtohen nga:

- *imaginata muzikore* (aftësia për të dalluar tingujt nga zhurmat, apo tingujt vokalë të njëri - tjetrit),
- *kuptimi i njojurive muzikore* (aftësia për të kuptuar konceptet muzikore),
- *pjesëmarrja në muzikë* (përvojat e tyre përmes krijimit, shprehjes, dëgjimit, improvizimit me muzikën).

### Objektivat

Veprimtaritë muzikore përgjatë programit të kopshteve duhet:

- Të zhvillojnë aftësinë për të dalluar tingujt *naturorë* dhe *muzikorë*, në mjedisin e tyre dhe jashtë saj;
- Të shpjegojnë lidhjen e tyre me muzikën në *klasë, shtëpi apo komunitet*;
- Të zgjerojnë njojuritë e tyre për muzikën *për fëmijë, popullore, klasike* etj;
- Të inkurajojnë nxënësit në përzgjedhjen e këngëve apo lojëra muzikore;
- Të udhëheqin nxënësit për të kriuar, dëgjuar, diskutuar, duke i bërë ata të ndjehen shumë mirë me muzikën.

Gjithashtu nxënësit duhet të kenë përvoja edhe në *artin figurativ*.

### Arti figurativ

#### Synimet

☞ *Programi i art figurativ* për këto mosha, ka si qëllim:

- të përfshijë dhe të sigurojë te nxënësit si duhet të përdorin materiale, mjete, procese të ndryshme për të zbuluar idetë, ndjenjat, identitetin dhe *imaginatën* e tyre.

### Objektivat

Për zhvillimin sa më të mirë të këtij programi është e rëndësishme që nxënësit të sigurojnë mundësitet për:

- Të zhvilluar aftësitë perceptuale;
- Të përdorin mjete, materiale dhe teknika të ndryshme gjatë krijimit;
- Të shpjegojnë *rolin e artit figurativ* dhe ndikimin e saj në shtëpi, mjedisin e klasës, shoqëri;
- Të zbulojnë rolin e *imazheve figurative* të çdo lloji në mjedisin dhe jetën e tyre të përditshme;
- Të vlerësojnë dhe mbajnë qëndrim ndaj artit figurativ përmes diskutimeve dhe vëzhgimeve, të punës së vet dhe të tjerëve.

## Vallëzimi

### Synimet

☞ Programi i vallëzimit në edukimin artistik për këto mosha, ka si qëllim:

- të inkurajojë fëmijët të kuptojnë vallëzimin në tërësi, duke mësuar valle të ndryshme;
- Fëmijët arrijnë:
- të zbulojnë, të reflektojnë dhe të mbajnë qëndrim rrëth valleve të ndryshme që ata mësojnë.

### Objektivat

Përmes këtij programi fëmijët do të sigurojnë mundësitë për:

- Të marrin pjesë në vallëzime të ndryshme;
- Të vallëzojnë në mënyrë shprehëse, duke vlerësuar veten dhe të tjerët gjatë kërcimit;
- Të vlerësojnë lidhjen midis vallëzimit në klasë dhe vallëzimit në shtëpi e komunitet;
- Të zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar një vallëzim përmes vëzhgimeve, reflektimeve dhe diskutimeve.



Nr.	Linjat	Objektivat e të nxënësit	Konceptet
1.	Dramë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregojnë që <i>pjesët teatrale</i>, janë situata ku ata marrin pjesë dhe luajnë;</li> <li>Punojnë në grup me të tjerët gjatë dramatizimit të një pjese teatrale;</li> <li>Përdorin <i>imaginatën</i> gjatë lojës teatrale;</li> <li>Tregojnë që prezantimi skenik zhvillohet nga disa <i>personazhe</i> që quhen <i>aktorë</i>;</li> <li>Tregojnë se një prezantim skenik përfshin karaktere (personazhe) kryesore dhe të përgjithshme;</li> <li>Shpjegojnë se <i>kostumet, tingujt dhe muzika</i> mund të janë pjesë e mjaft prezantimeve skenike që ata shikojnë p.sh: <i>kecat dhe ujku, borëbardha, etj.</i>;</li> <li>Përshkruajnë pjesët që luajnë në mjedisin e tyre;</li> <li>Sjellin shembuj të pjesëve teatrale (për fëmijë) që shikojnë në shtëpi, komunitet etj.;</li> <li>Shpjegojnë efektet që krijon një pjesë teatrale tek ata;</li> <li>Marrin pjesë në diskutimet rreth një përvoje që ata kanë në interpretimin e një pjese teatrale;</li> <li>Tregojnë se sa e besueshme është një prezantim i një pjese teatrale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Pjesë teatrale</i></li> <li>- <i>Interpretim</i></li> <li>- <i>Imagjinatë</i></li> <li>- <i>Personazhe-Aktorë</i></li> <li>- <i>Kostume</i></li> </ul>
2.	Muzikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallojnë <i>tingujt natyralë</i> dhe <i>muzikorë</i>;</li> <li>Përdorin me fjalët e veta <i>tinguj, zhurma</i>, duke përmendur disa nga <i>karakteristikat dhe cilësitet e tyre</i>;</li> <li>Krijojnë tinguj të <i>ulët - të lartë, fortë- të butë, të gjatë – të shkurtër</i>;</li> <li>Zhvillojnë ndjenjën ritmike përmes <i>fjalive me fjalë 2-3-4 rrokësh, në muzikë dhe në mjedis</i>;</li> <li>Zhvillojnë modele ritmike të marra nga fjalitë, nga muzika apo mjedisi;</li> <li>Eksperimentojnë me zë dhe <i>instrument</i>, duke krijuar dhe imituar;</li> <li>Dallojnë <i>zërin që flet</i> dhe <i>zërin që këndon</i>;</li> <li>Të dallojnë ndryshimet midis zërave të <i>tij/saj</i> dhe zërave të <i>tjerë</i>;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Tinguj nga natyra dhe tingujt muzikorë Zhurmat</i></li> <li>- <i>Karakteristikat e tingujve</i></li> <li>- <i>Ritmi</i></li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Të dallojnë ndryshimet e tingujve p.sh: <i>midis instrumenteve</i>;</li> <li>Të zbatojnë <i>karakterin shpejt – ngadalë</i> në këngë apo lojëra muzikore;</li> <li>Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë, me tematikë të ndryshme: <i>shoqërore, natyra, familja, kopshti etj.</i>;</li> <li>Të luajnë dhe këndojnë lojëra të ndryshme muzikore</li> <li>Të dëgjojnë muzikë të krahinave të ndryshme, duke treguar se ka disa lloje muzikash;</li> <li>Të dëgjojnë muzikë me dëshirë;</li> <li>Të përgjigjet pjesëve muzikore që dëgjon në <i>mënyrë verbale</i> ose <i>joverbale</i> (p.sh me lëvizje trupore ose vizatime të ndryshme).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Zëri (folës dhe vokal)</b></li> <li>- <b>Instrument muzikor</b></li> <li>- <b>Kënga</b></li> <li>- <b>Dëgjimi</b></li> </ul>
3.	<b>Arti figurativ</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorin <i>mjete, materiale dhe teknika</i> të ndryshme gjatë punëve të tyre;</li> <li>përzgjedhin materialet e duhura të artit dhe mjetet që u duhen;</li> <li>Shpjegojnë kuptimin e fjalëve: <i>vija, ngjyra, forma</i>;</li> <li>Përcaktojnë <i>lloje të ndryshme vijash</i> në mjeshterin që i rrëthon dhe në punët e tyre të artit;</li> <li>Përcaktojnë <i>ngjyrat</i>: <i>të ngrohta (kuqe, verdhë, portokalle)</i> - <i>të ftohta (blu, jeshile, lejla)</i>, në mjeshterin që e rrëthon dhe në punët e tyre të artit;</li> <li>Përcaktojnë disa <i>forma (gjeometrike dhe natyrore)</i> në mjeshterin që e rrëthon apo në punët e tyre të artit;</li> <li>Krijojnë modele të ndryshme me <i>plastelinë</i>;</li> <li>Kërkojnë për <i>modele</i> në mjeshterin që e rrëthon apo në punët e tyre të artit;</li> <li>Diskutojnë punët e artit, të vetat apo nga libra ilustrativë;</li> <li>Shpjegojnë punët e tyre të artit dhe të tjera;</li> <li>Përshkruajnë disa lloje të artit figurativ;</li> <li>Shpjegojnë punët (krijimet) me dëshirë dhe kuriozitet;</li> <li>Reflektojnë mbi punët e veta dhe të tjera;</li> <li>Diskutojnë për artin figurativ në komunitetin e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Mjetet, materialet, teknikat</b></li> <li>- <b>Vijat</b></li> <li>- <b>Ngjyrat: ngrohta e të ftohta</b></li> <li>- <b>Format</b></li> <li>- <b>Modelet</b></li> <li>- <b>Histori dhe kulturë</b></li> </ul>

4.	<b>Vallëzimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillojnë në mënyrë të vetëdijshme gjatë vallëzimit, veprimet që lidhen me <i>trupin, hapësirën dhe lëvizjet e vallëzimit</i>;</li> <li>• Vallëzojnë duke zbatuar gjatë kërcimit një shumëllojshmëri dinamikash si p.sh: <i>shumë shpejt, shumë ngadalë etj.</i>;</li> <li>• Kërcejnë duke mbajtur saktë <i>kohën</i> (p.sh përmes goditjeve me shuplaka);</li> <li>• Kontrollojnë hapësirën që i duhet për të vallëzuar;</li> <li>• Vallëzojnë duke zbatuar termat: <i>afër, larg, përmes, në mes, në qendër, mbrapa, nën, mbi, brenda, rreth e qark, udhëheqës, ndjekës</i>;</li> <li>• Demonstrojnë lëvizje të ndryshme, qoftë edhe të kopjuara;</li> <li>• Shprehin përmes kërcimit: <i>imagjinata, ndjenja etj.</i>;</li> <li>• Improvizojnë modele të ndryshme kërcimi si: <i>bashkëkohore, popullore, etj.</i>;</li> <li>• Shpjegojnë vallëzime të ndryshme me dëshirë dhe kuriozitet;</li> <li>• Reflektojnë rreth vallëzimeve të ndryshme që kërcejnë apo shikojnë;</li> <li>• Zbulojnë lidhjet e vallëzimit me arte të tjera si: <i>dramën, muzikën, artin figurativ etj.</i>;</li> <li>• Diskutojnë evenimentet e vallëzimit që janë bërë në komunitet.</li> </ul>	<p><b>- Trupi</b>  <b>- Hapësira</b>  <b>- Lëvizjet</b>  <b>- Dinamika – Shpejt, Ngadalë</b>  <b>Figura vallëzuese</b>  <b>Kërcimtarë</b></p>
----	------------------	---	---

### **III. MJETE DHE MATERIALE**

#### **Dramë**

- **Gérshërë**
- **Beze në ngjyrë të kuqe për sfondin e skenës**
- **Personazhe teatri – kukulla të ndryshme**
- **Maska të ndryshme – të kafshëve apo personazheve të njojur**
- **Letra A4**
- **Ngjyra – lapustila, lapsa me ngjyra, akuarele**
- **Karton**

#### **Muzikë**

- **Magnetofon**
- **Kaseta**
- **Lodra**
- **Dajre**
- **Organo**
- **karton**
- **lapustila**
- **gozhda**
- **letra me ngjyrë**
- **shkopinj**
- **kapak tenxhere**
- **kanoçe coca-cola**
- **kapakë të shisheve të birrës**

#### **Art figurativ**

- **Kavaleta**
- **Penela**
- **Gérshërë**
- **Pinestra**
- **Ngjitëse (skoç)**
- **letër e bardhë A4**
- **letër kalk**
- **letër varaku**
- **letër me ngjyrë A4**
- **letër e shndritshme**
- **karton**
- **lapsa me ngjyrë**
- **pastele**
- **lapustila**

- bojëra uji
- plastelinë
- argjilë
- pluhur allçie
- rërë

***Materiale të ricikliueshme***

- lesh me ngjyra
- penj me ngjyra të ndryshme
- fasule
- oriz
- grurë
- lëvozhga veze
- gazeta
- kuti shkrepse
- arra
- rruaza
- tapa shishesh
- boçe pishe
- guacka
- gozhda

## PROGRAMI I EDUKIMIT FIZIK DHE SHËNDETËSOR PËR MOSHËN 5-6 VJEÇARE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

### **1. HYRJE**

Programi i edukatës fizike për moshën 5-6 vjeçare synon t'i motivojë dhe t'i aftësojë fëmijët për të kryer veprime fizike të thjeshta në përshtatje me moshën dhe synon mirërritjen e tyre fizike dhe shëndetësore.Nga ana tjetër ky program synon t'i parapërgatisë fëmijët me kërkeshat që do t'u ofrojë edukata fizike, si lëndë zyrtare në arsimin fillor.

Standardi i detyrueshëm për arsimin parashkollor lidhur me kujdesin shëndetësor dhe fizik ka të bëjë me sigurimin e një mjedisi të sigurtë dhe të shendetëshem, i cili siguron një përshtatshmëri dhe shfrytëzim të mirë të mjedisit fizik të brendshëm dhe të jashtëm.Mjedisi përfshin aparatura, pajisje dhe materiale që e lehtësojnë fëmijën që të mësojë dhe të zhvillohet.

Në këtë kontekst ky program është një përpjekje për të paraqitur disa aftësi fizike që lidhen në mënyrë të natyrshme me mirërritjen shëndëtesore të fëmijës së moshës 5-6 vjeçare.

Kështu, drejtime të tillë si: *lëvizja, orientimi në hapësirë dhe koordinimi i mirë i vvetvete, ndërgjegjësimi për një shëndet të mirë përmes zbatimit të rregullave të nevojshme për shëdetin ose përdorimi i pajisjeve të ndryshme rrëthanore dhe të posaçme në funksion të shëndetit* konsiderohen si të domosdoshme për të mos thënë, si shumë të rëndësishme për edukimin e kësaj moshe me nevojat e duhura për shëndet dhe rritje fizike të qëndrueshme. Këta elementë janë pjesë përbërse e këtij programi, i cili zberthehet në linja, objektiva dhe koncepte kryesore, të cilat janë një përpjekje që mësuesit e kopshteve të lehtësojnë të kuptuarit e tyre, por akoma më shumë zhvillimin e frytshëm të këtij programi gjatë zbatimit konkret në kopsht.

## 2. LINJAT KURRIKULARE

Linjat
<ul style="list-style-type: none"><li>❖ Lëvizja</li><li>❖ Orientimi në hapësirë.</li><li>❖ Ndërgjegjesim për shëndetin dhe trupin</li><li>❖ Përdorimi i pajisjeve</li><li>❖ Përdorimi i mjeteve dhe i materialeve</li></ul>

## 3. PROGRAMI I DETAJUAR SIPAS LINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE KONCEPTEVE

Nr	Linjat	Objektivat	Koncepte
1	Lëvizja	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të lëvizë lirshëm me kënaqesi dhe vetëbesim gjatë lojërave dhe në mijedisin ku jeton</li><li>• Të kryejë lloje të ndryshme veprimesh si: vrapim, kercim rreshqitje, zgjatje, rrotullim etj.</li><li>• Të kontrollojë shpejtësine e lëvizjes dhe ndryshimin e drejimit.</li><li>• Të orientohet me sukses në hapësirë kur luan.</li><li>• Të koordinojë mirë veten gjatë lëvizjeve dhe pozicioneve ndryshme në lëvizje</li></ul>	<b>Ecje,</b> <b>Lëvizje</b> <b>(vrapim,</b> <b>kërcim,</b> <b>rrotullim,</b> <b>rreshqitje,</b> <b>zgjatje,</b> <b>përkulje)</b> <b>Kohë</b>
2	Orientimi në hapësirë.	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të ulet, të ngrihet dhe balancohet me pjeset e ndryshme të trupit.</li><li>• Të vetëkontrollohet në një pozicion fiks.</li></ul>	<b>Hapësirë</b> <b>Natyrë</b> <b>Përshtatje</b> <b>Lojë</b>

			Drejtim Afér-Larg, Lart-poshtë
3	<b>Ndërgjegjesim për shëndetin dhe trupin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Formimi i shkathtësive në aspektin e zbulimit te vvetves.</li> <li>Të bashkëpunojë me shokët në ndarjen e detyrave.</li> <li>Te kryejë praktikat higjeno-sanitare gjatë ngrenies dhe fjetjes.</li> <li>Të zbatojë rregullat e domosdoshme për kudesin shëndetësor</li> </ul>	<b>Energji Kolonë Skuadër I gjatë-i shkurtër I hollë – i trashë Rregulla shëndetësore</b>
4	<b>Përdorimi i pajisjeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të tregojë rritje të kontrollit gjatë përdorimit të pajisjeve dhe konstruksioneve.</li> <li>Të ndërtojë objekte me konstruksione të mëdha.</li> </ul>	<b>Objekt Ndërtim Lartësi</b>
5	<b>Përdorimi i mjeteve dhe i materialeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të demostrojë rritjen e aftësive dhe kontrollin në përdorimin e mjeteve të vizatimit dhe shkrimit si dhe në lojrë atë ndryshme</li> <li>Të mirëmbajë mjetet dhe materialet qe ka në përdorim.</li> </ul>	<b>Prerje Përdorim Mirëmbajtje</b>

#### 4. Mjete të domosdoshme:

- Paralele druri në mjedisin e kopshtit,
- topa, litarë,
- stola gjimnastikor,
- tabelë basketbolli,
- unazë,
- flamur,
- dyshek gjimnastikor,
- ballona, trarë të vegjël ekuilibri,
- kalë prej druri, kaluç gjimnastikor,
- birila, rrathë, shkopinj gjimnastikorë,
- kaqe kartoni, spango, materiale ndërtimi, etj.

## **5. UDHËZIME DIDAKTIKE**

Ky program nuk mund të zhvillohet i shkëputur, veçmas dhe i ndarë nga fushat e tjera të formimit dhe zhvillimit të fëmijës, si mësimi i gjuhës ( të folurit, shkrimi, leximi, të dëgjuarit) matematika, formimi qytetar, artet etj, por duke parë lidhjet e mundshme që tematikat e përzgjedhura nga mësuesit, ose nga tematikat që sugjeroohen ata mund të krijojnë lidhje midis objektivave që ofrojnë fusha të ndrsyhme dhe mund t'i zbatojnë ato në praktikë. Metodologjia themelore në këtë grupmoshë sugjerohet “Të mësuarit përmes projekteve” e cila integron dhe ndërthur brenda një tematikë të të gjitha fushave të formimit, të paracaktuara në programin dhe standardet e arsimit parashkollor.

Zakonisht projektet duan shumë kohë për të përbushur qëllimet dhe objektivat e synuara, por normalisht puna me projekte duhet të zgjasë 1 muaj, në mënyrë që të përfshihen në të, të gjitha kërkesat që synon programi i arsimit parashkollor për moshën 5-6 vjeçare.

P.sh nëse gjatë një muaji do të punohet me projektin e titulluar “Ngjyrat”, kjo është një mundësi e madhe për të zhvilluar objektivat që paraqesin të gjitha fushat e formimit, por në veçanti për edukimin fizik dhe shëndetësor lidhen me linjën e orientimit në hapësirë dhe koordinimin e vetvetes. Metodat, teknikat dhe strategjitë që mësuesit do të ndjekin gjatë zbatimit të një projekti njëmuajor bazohen gjithnjë tek loja, tek ndërveprimi i fëmijëve midis njëri-tjetri dhe mjedisit rrethues, me pajisjet që kanë në disposicion etj.

Një mësuese e mirë e kopshtit sugjerohet ta ndërtojë punën e saj mbi këtë takтикë:

- Zgjidh një tematikë për të zhvilluar një projekt njëmuajor që përfshin dhe integron lirshëm të gjitha fushat e studimit të arsimit pareshkollor
- Identifiko në programet e moshën 5-6 vjeçare objektivat që kanë lidhje dhe përafërsi me njëri-tjetrin dhe që mund të jenë objekt studimi në një tematikë të caktuar
- Listo një listë metodash, teknikash dhe strategjish të frytshme, të cilat bazohen në ndërveprimin e fëmijëve dhe që lehtësojnë zhvillimin e projekteve
- Përcakto çdo ditë një temë të caktuar që do të zhvillohet nga bashkëveprimi i fëmijëve
- Mundëso të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten fëmijëve
- Mundohu të përfshish dhe prindërit gjatë zhvillimit të projektit
- Motivoji, nxiti dhe lavdëroji gjithmonë fëmijët
- Në fund të çdo muaji bëj konkluzionet e arritjeve të projektit dhe të fëmijëve me gojë, por detyrimisht me anë të dokumentimit të punës në grup dhe për secilin fëmijë në një dosje të posaçme
- Informo dhe mbaj lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre.

## B. SHTOJCË

### Mjete didaktike –ARSIMI PARASHKOLLOR (Për një klasë të kopshtit)

Nr	Emërtimi i mjetit	Sasia
	<b>Zhvillimi i aftësive bashkëpunuese</b>	
1	Enë kuzhine. (Kusi, tigan, pjata të sheshta dhe të thella, thika, pirunë, lugë të mëdha dhe të vogla)	3 komplete
2	Komplete çaji (filxhanë, pjata)	3 komplet
3	Sobë kuzhine	1 copë
4	Tezgë shitje	1 copë
5	Perime plastike	3 komplete
6	Fruta plastike	3 komplete
7	Kutia e veglave mjekësore	3 komplete
8	Kutia e veglave të marangozit	3 komplete
9	Kutia e sendeve të kukullës	3 komplete
	<b>Zhvillimi i aftësive manipuluese (Konstruksione)</b>	
10	Konstruksione me forma gjeometrike (Trekëndësh, paralelopiped, cilindër, kub, etj. rrëth 100 copë).	3 komplete
11	Konstruksione tulla ndërtimi (me madhesinë e tullës prej kartoni të trashë)	4 komplete
	Rokele me ngjyra	3 komplete
12	Konstruksione plastike	3 komplete
	Konstruksione floreshente	2 komplete
13	Konstruksione të tipeve të ndryshme (druri)	3 komplete
	Konstr.plastike të dhëmbëzuara	2 komplete
14	Billoqe ndertimi (në madhesinë e tullës, prej kartoni)	2 komplete
15	Figura njerzish (vajzë, djalë, burrë grua)	2 komplete
16	Kafshë shtëpiake & ferma (3 dimensionale)	2 komplete
17	Kafshë të egra & pylli (3 dimensionale)	2 komplete

18	Shpendë dhe pemët (3 dimensionale)	2 komplete
19	Kafshë të ujit dhe deti	2 komplete
20	Tabelë me forma gjeometrike ( Një tabelë gjeometrike (37x27 cm dhe 56 forma gjeometrike manjetike prej druri kator, trekëndor dhe drejtkëndor të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme, rrethor, gjysëm rrethor, çerek rrethor të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme.	3 komplete
21	Mozaik me ngjyra (Një tabelë plastike me brima dhe pineska plastike me 4 ngjyra blu, e kuqe, e verdhë, jeshile.	3 komplete
22	Tabele manjetike me forma të ndryshme plastike (trupi i njeriut, veshjet e djalit dhe vajzës, shtëpi, pemë, lule, forma të ndryshme me 6 ngjyra që formojnë figura etj.	3 komplete
23	Tapetë formues pazëll (për në dysheme)	3 komplete
24	Pazzël formimi i figurave ndryshme ( për tavolinë)	3 komplete
<b>Zhvillimi i leximit dhe i shkrimtit</b>		
25	Tabelë manjetike me të gjitha shkronjat	5 komplete
26	Tabela me figura me tematikë të ndryshme (psh. "Si të sillemi", "Shenjat e qarkullimit", "Shtëpia jonë", "Kopshti jonë", "Klasa jonë" etj.	6 komplete
27	Plotësimi i kalendarit (Tabelë me mjete lëvizëse që tregojnë diellin, shiun, borën, erën, dimrin, pranverën, vjeshtën verën,)	3 komplete
28	Mjetet e transportit (Tabelë për rregullat e qarkullimit)	3 komplete
29	Makina të ndryshme (vetura, kamionë, fuoristradë, betonierë, vinç, ambulancë, makinë policie, tren etj)	2 komplete
30	Tabela me tematika dhe formate të ndryshme që tregojnë histori të pa përfunduara	5 komplete
31	Pazëll me tematikë të ndryshme	2 komplete
32	Zhvillimi i aftësive dëgjuese (kaseta me përralla të incizuara)	5 përralla
33	Tabelë për ndërtimin e shtëpisë, kopshtit, klasës	2 komplete
34	Tabela për zhvillimin e të folurit psh kujdesi nga rreziqet	2 komplete
35	Loja e ngjyrave	
36	Tabelë me stinën e vitit	1 komplet
37	Libra me përralla dhe me ilustrime	10 libra
38	"Teatri ne tavoline", përrala të ndryshme	

	<b>Matematika</b>	
39	Tabelë manjetike me numrat 1-10	4 komplete
40	Njohja e formave (Tabelë me forma të ngjyrave dhe madhësive të ndryshme)	4 komplete
41	Lojë me konstruksione ( Formim katorri, trekëndor, rrëthor etj.)	4 komplete
42	Lojë domino me numra dhe forma	3 komplete
43	Treni i numrave	2 komplete
44	Tabelë manjetike me numra nga 1 – 10	3 komplete
45	Peshore të ndryshme.	4 copë
46	Orë me rërë	5 orë
47	Ngjyrosje figure sipas numrit	2 komplete
48	Numërorator	4 copë
49	Petëza me disa ngjyra dhe forma	5 komplete
	<b>Njohja e botës</b>	
50	Komplet lupash me madhesi të ndryshme	10 copë
51	Komplet manjetësh	10 copë
52	Termometra	5 copë
53	<b>Edukimi fizik-shëndetësor (brenda klasës)</b>	
54	Kolovajse dy vëndshe (Plastike)	1 copë
55	Kolovajse 4 vëndëshe (Plastike)	1 copë
56	Biçikleta me tre rrota	3 copë
57	Rrathë me ngjyra (4 ngjyra )	30
58	Kompletë birrilash	6 komplete
59	Topa me ngjyra	4 komplete
60	Komplete tenisi	4 komplete
61	Komplete pingpongu	4 komplete
62	Topa të madhësive të ndryshme	5 topa
	<b>Zhvillimi krijues</b>	
63	11 ngjyra bojtrash pluhuri për vizatim	12 kova
64	Bojëra gishtash	25 komplete
65	Komplet penelash të madhesive të ndryshme	3 komplete
66	Komplet lampustilësh	25 komplete
67	Komplet lapsash me ngjyra	25 komplete
68	Shabllone me figura kafshësh,	5 komplete
69	Shabllone me figura perimesh dhe frutash	5 komplete
70	Dajre	8 copë
71	Daulle	8 copë
72	Vegla të perkursionit	8 copë
	<b>Këndi i rërës dhe i ujit</b>	
73	Govatë rere dhe uji	1 copë
74	Enë rere dhe uji	5 komplete
75	Mjete për të luajtur me rërë dhe ujë	5 komplete
	<b>Lodra të ndryshme</b>	

76	Shtëpia e kukullës	5 komplete
77	Kukulla të ndryshme	10 kukulla
78	Çanta e kukullës	7 komplete
79	Lojë mos u nxe	5 copë
80	Konstruksione me figura	2 komplete
81	Tapetë formues (për dysheme)	2 komplete
82	Kafshë pellush	15 copë
83	Makina te tipeve të ndryshme	15 copë
84	Tren me shina	3 copë